



Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim

të pronës së paluajtshme Komunale

Nr.01/2020

Dt.03.02.2020

Në bazë të nenit 5,6,7,8 dhe 15 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Vendimit për caktimin e lokacionit për shërbimet me auto-merimangë nr.01Nr.30/13 dt.28.02.2013 të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë si dhe Vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale 01Nr.359/19 dt.26.12.2019 të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, Komuna e Vushtrrisë shpallë këtë:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTË TË PRONËS SË PALUJTSHME KOMUNALE PËR SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË AUTOMJETEVE ME AUTO-MERIMANGË

NENI 1: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK Komuna Vushtrri Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	Personi kontakt: Adnan Lahu Tel:044/566-407 Ilmi Zeqiri Tel:044/198-176
Adresa SHESHI ‘Ahmet Krasniqi’	Kodi postar 42000
QYTETI Vushtrri	Komuna Vushtrri
E-mail adnan.lahu@rks-gov.net	

NENI 2: LËNDA E ANKANDIT

Komuna e Vushtrrisë-**Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale**, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,nr.01Nr.30/13 të dt.28.02.2013 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,nr.01Nr.359/19 të dt.26.12.2019 ., ka përcaktuar dhënien në shfrytëzim afatshkurtë me kompensim të pronës së paluajtshme komunale përmes ankandit publik procedurës së ofertave të mbyllura.

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtë e pronës së paluajtshme komunale, si në vijim:

*Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70202010-00583-1 e cila përfshin një sipërfaqe prej 10057m² , Zona Kadastrale Bukosh , pronë e komunës së Vushtrrisë.

3.Të drejt pjesëmarrjes kanë personat fizik dhe personat juridik;

4.Kriteri i dhënies së kontratës :Oferta e përgjithshme me çmimin më të lart;

5.Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është 2 vite.

NENI 3: AFATET DHE PROCEDURAT

1. Ankandit Publik është i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së Ankandit;
2. Formulari për aplikim merret në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë te zyrtari z. Ilmi Zeqiri çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
2. Afati kohorë i fundit për tërheqjen e dokumentacionit të ankandit është një ditë para përfundimit të ankandit.
3. Afati kohorë për dorëzim-pranimin e aplikacioneve është data: 17.02.2020 , më së largu deri në ora 14:00 vendi Komuna e Vushtrrisë , zyra e pranim-it-arkiva, zyra nr.1 kati përdhese.
4. Ofertata duhet dorëzuar të mbyllura; tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në formë fizike dhe elektronike nëpërmes E-mail: ilmi.zeqiri@rks-gov.net.
5. Takimi për hapjen e aplikacioneve bëhet me datën: 17.02.2020 , vendi Salla e Kuvendit Komunal – Vushtrri në ora 14:30.
6. Informacionet shtesë mund ti kërkonit te z. Adnan Lahu dhe z. Ilmi Zeqiri , Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

NENI 4: ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë te Komisioni për Ankesa pran Komunës së Vushtrrisë, sipas dispozitave të nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092, Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.